

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË–DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Jonuz Bugari, si kryetar i trupit gjykues, gjyqtarëve porot: **Mustafë Cena** dhe **Selami Gashi**, anëtar të trupit gjykues, me bashkëpunëtorin profesional **Armond Omega**, në çështjen juridike të propozueses M. K. e lindur G. e lindur në fshatin R., tani me vendbanim në Rahovec, të cilin e përfaqëson avokati H. K. nga Prizreni, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, dhe propozuesit Xh. K. i lindur në fshatin Z., tani me vendbanim në Rahovec, të cilin e përfaqëson Avokati M. B. nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, për shkak të zgjidhjes së martesës me marrëveshje, pas mbajtjes dhe përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor jo publik, zbatimit të provave, pas këshillimit dhe votimit, më **28.06.2018**, morri këtë:

A K T G J Y K I M

ZGJIDHET ME MARRËVESHJE martesë në mes të propozueses **M. K.** e lindur **G.** lindur më ..., dhe propozuesit **Xh. K.** i lindur më ..., martesë e lidhur më ..., në Zyrën e Gjendjes Civile Rahovec, me nr. ser. **M ...**, me nr. rendor ..., dhe me numër të referencës **16|2010RM|16001**.

FËMIJËT – **M. K.**, e lindur më ..., dhe **V. K.**, e lindur më ..., i besohet në ruajtje, edukim, përkujdesje, dhe ushqimi, babait të tyre këtu propozuesit Xh. K..

OBLIGOHET propozuesi Xh. K., që këtu propozueses M. K., të ia lejoj kontaktin me fëmijët M. K. dhe V. K., në çdo të premtën e fundit të muajit prej orës 09 deri në orën 11, në zyrën e QPS-së Rahovec.

Propozuesja M. K., nuk kërkon alimentacion për vete, për këtë arsye gjykata nuk ka vendosur për alimentacion.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Propozuesit M. K. e lindur G. dhe Xh. K., nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, në këtë gjykatë kanë parashtruar propozim të përbashkët për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, kanë cekur se marrëdhëniet në kohët e fundit janë keqësuar në atë masë sa që jeta në bashkëshortësi e propozuesve është e pa mundur dhe e paqëndrueshme kështu që edhe në të ardhmen e njëjta për shkak të marrëdhënieve të acaruar nuk mund të vazhdohet.

Në lidhje me këtë çështje juridike gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor për datën 28.06.2018, në të cilën seancë është paraqitur përfaqësuesi i autorizuar i propozueses Av. H. K. dhe përfaqësuesi i autorizuar i propozuesit të dytë Av. M. B..

Përfaqësuesi i autorizuar i propozueses së parë ka deklaruar se ka deklaruar se ngel në tërësi si në propozim të përbashkët bashkëshortor për prishjen e martesës me marrëveshje, njëkohësisht ngeli edhe në marrëveshjen e arritur ndërmjet propozuesve sa i përket besimit të fëmijëve. Në të cilën marrëveshje propozuesit janë marrë vesh dhe janë dakorduar që fëmijët të lindur në martesë vajza V. dhe M. të i besohen në edukim ruajtje dhe përkujdesje prindërit babait të tyre këtu propozuesit Xh. K.. Sa i përket çështjes së përkujdesjes dhe edukim të fëmijëve sikurse që është theksuar në marrëveshje propozuesi nga propozuesja nuk kërkon kurrfarë alimentacion, propozuesja me propozim të parashtruar kërkon që martesë e lidhur ndërmjet propozuesve të prishet për arsye se në kohë të fundit kanë lindur mosmarrëveshje në mes tyre, kështu që për shkak të zënkave në mes tyre është e mendimit se tani e tutje kjo bashkësi martesore nuk mund të qëndrojë, dhe se tani për tani propozuesit jetojnë ndamës njëri me tjetrin. Për këtë arsye i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave propozimin e përbashkët për zgjidhjen e martesës me marrëveshje ta miratojë si të bazuar.

Përfaqësuesi i autorizuar i propozuesit të dytë, deklaroi se ngel në tërësi si në propozimin e përbashkët të ushtruar për zgjidhjen e martesës me shkurorëzim me marrëveshje. Në kohën e fundit pas lindjes së dy vajzave marrëdhëniet bashkëshortore janë përkeqësuar, acaruar për shkak të mentalitetit të ndryshëm për kundër tentativave që të vazhdohet një jetë bashkëshortore nuk ka mundur që të arrihet, jetojnë ndaras pas këtyre mosmarrëveshjeve, ndërsa fëmijët të mitur – vajzat janë në përkujdesje në edukim dhe mbajtjen tek bashkë propozuesi Xh. i cili posedon të gjitha kushtet e nevojshme për zhvillim normal të fëmijëve. Gjithashtu është bërë edhe marrëveshja ndërmjet bashkë propozuesve për mbajtjen, mbikëqyrjen dhe edukimin e fëmijëve, e cila është nënshkruar nga të dy propozuesit, me dakordim të plotë, pasi që propozuesja e rendit të parë nuk i ka kushtet e nevojshme për zhvillim normal të fëmijëve, andaj i ka propozuar gjykatës që pas procedimit të provave propozimin ta aprovojë si të bazuar.

Gjykata, për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike ka bërë administrimin e provave si në vijim: ka bërë shikimin e certifikatës së martesës me Nr.Ser. M ..., me numër rendor ..., me numër të referencës 16|2010RM|16001, e lëshuar pranë Zyrës së Gjendjes Civile në Rahovec, më datë 14.03.2018, me të cilën vërtetohet se M. K. e lindur G. lindur më ..., ka lidhur kurorë me Xh. K. i lindur më ..., ka bërë shikimin në certifikatën nga Registri Qendror i Gjendjes Civile me Nr.Sr. L ..., të lëshuar me datë 14.03.2018, nga Zyra e Gjendjes Civile në Rahovec, me të cilën vërtetohet se fëmija M. K., është e lindur më ..., në Prizren, nga prindërit M. K. e lindur G. dhe Xh. K., ka bërë shikimin në certifikatën nga Registri Qendror i Gjendjes Civile me Nr.Sr. L ..., të lëshuar me datë 14.03.2018, nga Zyra e Gjendjes Civile në Rahovec, me të cilën vërtetohet se fëmija V. K., është e lindur më ..., në Rahovec, nga prindërit M. K. e lindur G. dhe Xh. K., ka bërë shikimin në raportin e Qendrës për Punë Sociale të datës 12.06.2018. nr.02-.../2018, nga i cili raport vërtetohet se fëmijët e mitur M. K. dhe V. K. të i besohen të atit të tyre Xh. K. ngase ai është i përshtatshëm për përkujdesje, ruajtje dhe edukim të fëmijës pasi që të dy bashkëshortët kanë bërë marrëveshje paraprake, si dhe ka bërë shikimin në marrëveshjen e bashkëshortëve lidhur me besimin e fëmijëve, pas zgjidhjes së martesës së tyre me marrëveshje e përpiluar me datë 20.03.2018.

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave, duke u bazuar në nenin 8 të LPK-së, e në bazë të bindjes së lirë, është konstatuar se propozimi i përbashkët i propozuesve për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, është i bazuar dhe i njëjti është aprovuar.

Si fakt relevant në këtë çështje juridike gjykata muar për bazë se propozimi për zgjidhjen e martesës me marrëveshje palët e kanë bërë bashkërisht, janë marrë vesh që më e mira për të ardhmen e fëmijëve është që martesën ta zgjidhin me marrëveshje të përbashkët, si dhe të njëjtit kanë arritur marrëveshjen edhe lidhur me besimin e fëmijëve dhe kontakteve me fëmijët.

Andaj në bazë të gjendjes faktike të cekur më lartë dhe duke u bazuar në dispozitat neneve 68, 69 dhe 84 të Ligjit mbi Familjen i Kosovës dhe nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është mbështetur në dispozitën e nenit 450 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
C.nr. 83/2018, më 28.06.2018.

B. Profesional
Armond Qmega

Kryetari i trupit gjykues
Jonuz Bugari

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ankesa paraqitet ndërmjet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit Divizioni Civil në Prishtinë.